



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. F87/7 Prot

Tiranë, më 14/10/2015

V E N D I M

Nr. 43, datë 14/10/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Bar Dubai" Tiranë,

V Ë R E J S E

Në zbatim të Urdhrit nr. 174 datë 07/09/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Bar Dubai", regjistruar në Q.K.R. me emër subjekti tregtar Enrik Skënderi dhe NIPT L21702009D, me objekt:

- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" (i ndryshuar).
- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

Kontrolluesi "Bar Dubai" ka shkelur rëndë nenin 32 (Detyrimi për Bashkëpunim) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), sipas të cilit:

1. Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre.
2. Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterave, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj.

Grupi i hetimit administrativ kontaktoi në vend administratorin e "Bar Dubai", paraqiti mjetet e identifikimit, prezantoi autoritetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen

e të Dhënave Personale dhe e informoi me Urdhrin nr.174 datë 07/09/2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “për kryerjen e hetimit administrativ” që do të ushtrohet pranë tij.

Kontrolluesi “Bar Dubai”, ka refuzuar bashkëpunimin me argumentin se ai garanton akses në sistemin e video-vëzhgimit vetëm për policinë e shtetit dhe prokurorinë.

Përpjekjet e grupit të hetimit administrativ për të filluar kontrollin sipas objektit të Urdhrit pranë kontrolluesit, rezultuan të pasuksesshme për arsye se përfaqësuesi i kontrolluesit i kërkoi grupit të kontrollit të largohet nga ambientet tij menjëherë, duke pretenduar në të njëjtën kohë se kamerat janë false dhe nuk punojnë.

Grupi i hetimit administrativ ka mbajtur procesverbal për çfarë ka ndodhur.

Për të vijuar më tej procedurat e kontrollit, nëpërmjet shkresës nr. 787/2 protokollit datë 09/09/2015, është kërkuar ndihmë dhe bashkëpunim nga Komisariati i Policisë nr. 2, me qëllim mbështetjen nga ana e tyre, për kryerjen e hetimit administrativ pranë kontrolluesit “Bar Dubai”, në datën dhe orën e përcaktuar nga K.D.I.M.D.P.

Në datën 18/09/2015, grupi i hetimit administrativ është paraqitur në ambientet e kontrolluesit dhe ka filluar hetimin administrativ sipas objektit të Urdhrit përkatës.

Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ në vend, janë konstatuar të instaluar 4 (katër) kamera të cilat janë të fokusuar në drejtim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të lokalit si dhe 1 (një) kamera tjetër, e cila është e vendosur në korridorin në hyrje të tualeteve.

Ka qenë e pamundur të identifikohet pajisja DVR/NVR (Digital/Network Video Recorder) apo kompjuter, në ambientet e brendshme të kontrolluesit. Kjo pajisje shërben për menaxhimin e imazheve-video (mbledhjen, përpunimin, kohën e ruajtjes, rikthimin etj.) të marra nëpërmjet kamerave të këtij sistemi. Përfaqësuesit të kontrolluesit i është kërkuar informacion dhe akses në sistemin e video-vëzhgimit (CCTV) dhe më konkretisht në pajisjen video-regjistruese DVR, NVR apo kompjuter, por ai ka refuzuar të krijojë akses në sistemin e arkivimit duke deklaruar se pajisja regjistruese dhe regjistrimet i ruan në shtëpi dhe për këtë arsye është i pamundur aksesimi në sistemin e video-vëzhgimit (CCTV).

Është konstatuar gjithashtu se subjektet e të dhënave që frekuentojnë ambientet e kontrolluesit nuk informohen mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit CCTV.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga grupi i kontrollit është mbajtur procesverbal i dytë, në të cilin janë shënuar shkeljet e gjetura si dhe janë realizuar fotografi të vend-ndodhjeve të kamerave. Përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka pranuar të bënte komente rreth konstatimeve të grupit të kontrollit, megjithatë e ka firmosur procesverbalin e mbajtur në vend.

Veprimi i kryer nga ana e kontrolluesit “Dubai Bar” dhe sjellja e tij me tendencë të hapur mosbashkëpunimi me autoritetin e Komisionerit, e vendos subjektin në shkelje të rëndë të nenit 32 (Detyrimi për Bashkëpunim) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar).

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 07 dhe 14/10/2015 janë organizuar seancat dëgjimore, ku kontrolluesi është njoftuar për tu paraqitur dhe për të shprehur pretendimet e tij. Në të dy këto seanca dëgjimore, kontrolluesi nuk është paraqitur, ndonëse për seancën e datës 14/10/2015, nga Posta Shqiptare është konfirmimi zyrtar për njoftimin e tij.

Si përfundim, konkludoj se shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar), përbën “kundërvajtje administrative” dhe sanksionohet me gjobë.

- “dh/1) kontrolluesit dhe përpunuesit, që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë.”

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është tepër e serioze, pasi me sjelljen e tij, kontrolluesi ka penguar kryerjen e detyrës funksionale nga ana e Zyrës së Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 29, 30, 32, 39/1, pika “dh/1”, të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar), si dhe nenet 107-109 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit “Bar Dubai” me gjobë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar).
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit, sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar) dhe nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky Vendim u shpall sot më 4/10/2015.

